



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:237362
Datë: 02.02.2024
Numri i dokumentit: 05277352

C.nr.1788/2010

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen kontestimore të paditësit B. G. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. N. M. nga Prishtina, kundër të paditurit S. V. nga Prishtina, tani me adresë të panjohur, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, jashtë seancës me datë 01.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me numër C.nr.1788/2010, e paditëses paditësit B. G. nga Prishtina, kundër të paditurit S. V. nga Prishtina, tani me adresë të panjohur, me objekt kontesti për vërtetimin e pronësisë, për shkak të mos pagesës së deponimit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë, përmes të autorizuarit së tij, me datë 12.08.2010, kundër të paditurit ka ushtruar padi, me objekt kontesti për vërtetimin e pronësie.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me datën 21.03.2022 ka dorëzuar në gjykatë parashtrësën me të cilën ka kërkuar që të paditurit ti caktohet përfaqësuesi i përkohshëm.

Pas kësaj gjykata me datën 21.11.2023 ka marr aktvendim për deponim, dhe të njëjtin ja ka dërguar të autorizuari të paditësit av. N. M. nga Prishtina, të cilin i njëjti e ka pranuar më datën 06.12.2023 (kjo konfirmohet nga flete dërgesa për dorëzim personal), mirëpo i njëjti nuk e ka bere deponimin brenda afatit ligjor.

Nga këto të cekura e në mbështetje të dispozitave ligjore të nenit 79, 81, 99.2,102.1, dhe 387 pika o) e lidhur me nenin 391 pika g të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1788/2010, më 01.02.2024

Përparim Zeka

Gjyqtar

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të së njëjtit, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të dorëzohet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.